



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 338/2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga Muhamet Rexha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së billboardave garues për zgjedhjet e përgjithshme para fillimit të fushatës zgjedhore, në seancën e panelit të mbajtur me 08.12.2010, mori këtë:

V E N D I M

HIDHET poshtë ankesa si e palejuar.

A R S Y E T I M

Subjekti politik PDK, ka parashtruar një ankesë më të cilën pretendon se subjekti politik LDK, ka bërë shkelje të Rregullës Zgjedhore nr.11/2009, Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, duke vendosur billboardet, me përmbajtje garuese për zgjedhjet e përgjithshme para se të filloj fushata zgjedhore.

Më 06.12.2010, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik PDK me të cilën pretendohet se subjekti politik LDK ka bërë shkelje të Rregullës Zgjedhore nr.11/2009, Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët duke vendosur billboardet, me përmbajtje garuese për zgjedhjet e përgjithshme para se të filloj fushata zgjedhore..Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një fotografi që duken të jenë billboardet e fushatës së subjektit politik LDK. Parashtruesi i ankesës ka propozuar që PZAP-i të ndër marrë masat e parapara ligjore për këtë çështje konform dispozitave të aplikueshme.

PZAP-i pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se ankesa është e palejuar duke u bazuar në nenin 44 të LZP-së, në të cilin përcaktohen aktivitetet e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore dhe mënyrat e specifikuar në këtë dispozitë. Në dispozitën e nenit 33 të LZP-së dhe në Rregullën Zgjedhore nr.11/2009, Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët ju ndalohen veprimet e subjekteve politike, mbështetësve të tyre ose kandidatëve të tyre gjatë periudhës së fushatës zgjedhore. Meqenëse veprimet e pretenduara nga parashtruesi i ankesës nuk janë bërë gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, PZAP-i vlerëson se në

pajtim me dispozitat e lartcekura ligjore nuk kemi të bëjmë me veprime të ndaluara. E në kuptim të dispozitës së nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 338/2010 më datën 08.12.2010.

